



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturore, Peizazh kulturor**

**EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR: KISHA DHE SHKOLLA FILLORE
NË GJUHËN SHQIPE NË STUBËLL TË EPËRME**

Fotografi pamje karakteristike, dt...



Datimi/et (Relative): 1584 / 1846 /1868 / 1905

Periudha/t historike: Osmane

Adresa: Vendndodhja, Qyteti/Fshati, Komuna: Stubëll e Epërme, Komuna e Vitisë

Lloji i asetit të propozuar:

(Kategoria ligjore dhe Nënkatëgoria sipas nenit 2 të LTK)

Kategoria: Arkitekturore

Nënkatëgoria: Monument

Numri i inventarit (unik): 002741

Numri i regjistrimit në KKTK:

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/ referenca e dokumentit/aktit nëse ka:

Akti i mëhershëm nëse ka

Nr.v. E.K. 02-258/78

Ne mbrojtje të përkohshme: 2012/2013/2013/2015 (Nr. i vendimit T.K 116/2015 09.10.2015)

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Të përshkruhet arsyetimi se përse asetit i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.

Është objekt që ka vlera historike dhe arkitekture. Rëndësi të madhe ka sepse është objekt i shkollë së parë shqipe në Rajonin tonë, përkatësisht sipas shënimeve ka filluar punën si kolegji i Shën Lukës, qysh në vitin 1584.

Me ndërprerje të kohëpaskohshme, ky objekt ka shërbyer edhe për ceremoni fetare të riteve krishtere. Shkolla shqipe ka funksionuar edhe gjatë vitit 1846, ndërsa si mësim i rregullt mbahet nga viti 1868, deri sa është zyrtarizuar nga Austro-Hungaria në vitin 1905. Edhe objekti i punuar nga brenda e jashtë ka vlera që duhet çmuar e ruajtur, ngase janë punuar nga mjeshtrit vendor shqiptarë. Po ashtu në të ruhen edhe foto, libra e dokumente tjera ku pasqyrohet puna e piktorëve, jeta fshatare shqiptare, lutjet e banorëve vendas, dhe sakrifica e shqiptarëve për të ruajtur identitetin fetar e kombëtar. Gjithashtu, në oborrin e objektit gjendet busti i Mikel Tarabulluzit dhe një monument kushtuar Martirëve të Karadakut (1846-1848).

Pra, Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë – Kisha e Shën Gjergjit paraqet një monument me rëndësi të veçantë historike, shoqërore e kulturore.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar asetit

Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nent 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlerat Historike:

Ky monument paraqet vjetërsinë dhe zhvillimin e shkollës shqipe që nga shek. XVI, sikurse edhe mbajtjen gjallë të kishës katolike të komunës së Vitisë përkatësisht të fshatit Stubëll.

Vlera artistike:

Nuk është ndonjë ndërtesë e madhe, megjithatë enterieri dhe eksterieri kanë elemente artistike të kohës kur është ndërtuar. Ka përdheshën dhe katin, që karakterizohet me ndërtime dhe stilizime të veçanta. Ndërtesa është e vendosur në drejtimin perëndim – lindje dhe ka planimetri në formë të shkronjës L. Absida gjendet në murin verior, pranë së cilës ndodhet edhe altari. Nga hyrja e priftërinjve, salla ndahet me dy shtylla, të cilat mbajnë një mur në formë harku, ndërsa një ndarje tjetër ndërmjet altarit dhe pjesës tjetër të sallës është improvizuar me dy shtylla pa kapitel. Altari dhe tryeza e altarit janë veshur me gurë të përpunuar. Po kështu, edhe absida është e dekoruar me një friz, ngjyrash të shembullit të shamisë së Nënë Terezës. Në brendësi të absidës ndodhet një katrore i gravuar në të cilin zë vend kryqi me Jezusin. Ndërsa edhe hajati i është i vendosur në tri shtylla.

Vlera Shpirtërore:

S'ka dyshim se ky objekt paraqet edhe vlera shpirtërore ngase që nga viti 1584 ka filluar punën edhe si faltore e besimit katolik. Edhe pse ka pasur ndërprerje të kohëpaskohshme, aty janë kryer ceremonitë fetare të popullatës shqiptare të kësaj ane.

Vlera shkencore:

Ndërtesa e shkollës së parë shqipe në Stubëll mund të jetë objekt studimi për mënyrën e ndërtimit të objektit, materialin e saj të ndërtimit, sikurse edhe për vjetërsinë dhe rolin e saj që

ka luajtur si shkollë dhe si objekt fetar që nga ndërtimi i saj e deri më tani, Pastaj edhe artistët dhe letrarët kanë hapësirë për të studiuar disa vepra arti si dhe shkrime që gjenden e mund të gjenden në të ardhmen për këtë objekt me rëndësi për trevat tona.

Vlerat shoqërore;

Ky objekt ka edhe vlera shoqërore, ngase këtu janë krijuar mundësitë që të mësojnë nxënësit dhe të njihen në mes veti,. Po ashtu qytetarët e fshatit e më gjerë kanë pasur rastin të takohen në rastet e ceremonive fetare, sikurse të bashkëbisedojnë për problemet e ndryshme të tyre. Edhe pse sot nuk funksionon si shkollë dhe as si vend ku kryhen ceremonitë fetare, atë e vizitojnë njerëz nga vise të ndryshme të Kosovës e më gjerë , sikurse edhe mbahen takimet letrare të Dom Mikel Tarabulluzit.

Rariteti: Shkolla e parë Shqipe, është njëra prej shkollave të para shqipe në Kosovë.

Propozuesi: QRTK-Gjilan

Institucioni: QRTK -Gjilan

Emri/ Mbiemri: Arton Hoxha Nënshkrimi

Adresa dhe kontakt informacione: Rruga, “Adem Jashari” nr. 28

Data : 31.03.2016

Bashkangjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit:
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit:
5. Dokumentacioni përcjellës:

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt..../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa: Komuna e Vitisë, Stubëll e Epërme

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Vitia për herë të parë përmendet në vitin 1258 në krisobulën e Carit Bullgar Tih Asenit, pastaj e gjejmë në defterin kadastral të Vilajetit Vëllk, të vitit 1455, në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë (1566-74), në librin e dhuratave të Manastirit të Deviçit si dhe në sallnamet e Vilajetit të Kosovës. Në vitin 1927 Vitia shpallet qytezë. Në vitin 1963 formohet Kuvendi Komunal i Vitisë.

Literatura:

Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 7 - Vitia, Prishtinë 2004.

Oblast Brankoviça – Opshirni katastarski popis iz 1455 godine, Sarajevo, 1972, Seria II, Defteri – Knjiga 2, sv. 1 Defter-i Mufassal-i Vilayet Vlk, sene 859).

Dr. Muharem Cërabregu, Kosova në hartat e vjetra, Prishtinë, 1977.

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNewRef I)

N: 42.317467, E: 21.467397, LMB: 814 m.

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Gjendet në Stubëll të Epërme, në pjesën veriore të fshatit.

Perimetri i asetit të propozuar: _____ m²,

Zona rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: _____ m², _____ ha

Sipërfaqja totale: 3052 m²

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese P=1:500 dhe 1:200 (nëse është e aplikueshme).
- Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.
- Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratografinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- *Përshkrimi i asetit të propozuar nga momenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.*
- *Në rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël apo lokalitetet) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit, stili arkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimi dhe aspektet tjera ndërlidhëse të lokacionit të aseti, siç janë tereni, oborri, mobiljet, pikturat, mbishkrimet, mjedisi rreth tij, etj.*
- *Në rastet e qyteteve ose të një kuarti historik, të bëhet përshkrimi i ndërtesave historike kryesore të karakterit publik dhe plani i bazës së sipërfaqës perimetrale të asetit me përshkrimin e mjedisit rrethues.*
- *Ndërlidhur me lokalitetet apo rezervatet arkeologjike dhe artin shkëmbor, të bëhet përshkrimi i peizazhit mjedisor. Ndërsa, peizazhi kulturor të përshkruhet njëjtë si në rastet e lartëshënuara, duke përqëndruar vëmendjen në specifikat e interakcionit historik ndërmjet natyrës dhe njeriut.*

Kisha e Shën Gjergjit, ndryshe e njohur si Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë, ka një objekt të fortë, i cili është ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqereje për bodrumin, si dhe tulla po me llaç gëlqereje për katin sipër. Është ndërtuar në terren të pjerrtë, ku formohen bodrumi dhe përdhësja dhe ka planimetri në formë të shkronjës L. Objekti është i vendosur në drejtimin perëndim – lindje. Ndërsa hyrja për bodrumin ku është e vendosur salla e lutjeve bëhet nga dy hyrje të veçanta, njëra për priftërinjtë, e tjetra për besimtarët. Absida, ose më mirë një improvizim i saj është bërë në murin përballë, pra në veri, pranë së cilës ndodhet edhe altari. Pranë hyrjes së parë, pra hyrjes nga hyjnë priftërinjtë ndodhen dy libra liturgjik: i pari është “Meshari Romak”, ndërsa i dyti është “Shenjtoret dhe festat”. Në mur janë të varur disa korniza me mbishkrime dhe fotografi me motive fetare, sikurse edhe me motive shqiptare. Në sallën e lutjeve janë të vendosura karrige. Objekti shihet se është rinovuar disa herë. Salla ka tri dritare në ballin jugor dhe dy të tjera në atë lindor. Nga hyrja e priftërinjve, salla ndahet me dy shtylla, të cilat mbajnë një mur në formë harku, ndërsa një ndarje tjetër ndërmjet altarit dhe pjesës tjetër të sallës është improvizuar po me dy shtylla pa kapitule. Altari dhe tryeza e altarit janë veshur me gurë të përpunuar. Po kështu, edhe absida është e dekoruar me një friz, ngjyrash të shembullit të shamisë së Nënë Terezës, një dekorim i mëvonshëm. Në brendësi të absidës ndodhet një katrore i gravuar në të cilin zë vend kryqi me Jezusin. Katrori është rrethuar me dru, ndërsa mbi të është gravuar viti 1846 me një laskar të hardhisë si bazë.

Në katin sipër bodrumit ndodhen disa kthina, të cilat kanë shërbyer për nxënësit si dhoma mësimi si dhe për udhëheqësit fetarë të kishës.

Hyrja në katin e dytë bëhet nga porta që është në perëndim, ndërsa kisha ka edhe hajatin e vendosur në tri shtylla. Vetë hajati ka një formë të gjysmërrethit, në dukje një absidë nga perëndimi. Mbulohet me kulm dy ujor, që përcjell tërë planimetrinë. Në pjesën perëndimore

është e ngritur kambanorja me bazë katrore, e mbuluar me kulm katër ujor. Fasada ka trajtim të thjeshtë linear, është e suvatuar dhe e ngjyrosur.

Në oborrin e Kishës është përmendorja e Don Mikel Tarabuluzit, si dhe një monument kushtuar Martirëve të Karadakut 1846-1848.

Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë – Kisha e Shën Gjergjit paraqet një monument me rëndësi të veçantë historike, shoqërore e kulturore.

Shtojçë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës.

Funksioni aktual:

Muze dhe Kishë për rite fetare.

Pronësia:

Ipeshkvia e Kosovës

Shfrytëzuesi:

Me rastin e takimeve të Dom Mikel Tarabuluzit ky aset shfrytëzohet nga komuniteti letrar. Kjo ndërtesë është në përkujdesje të Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjilan, si institucion përgjegjës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rajonin e Gjilanit.

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit:

- *Përshkrimi i formësimit të asetit nga themelimi deri në gjendjen aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet domethënëse në historinë e konservimit.*
- *Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për monumente, ansamble dhe lokalitete. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartëshënuara, duke përfshirë aspektin e historisë së aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror.*

Shkolla e parë Shqipe në Kosovë –Kisha e Shën Gjergjit gjendet në fshatin Stubëll e Epërme, komuna e Vitisë. Historiku i saj është më i hershëm sesa koha e emërimit të saj dhe, pikërisht është fjala për Kolegjin e Shën Lukës, i cili kishte filluar punën qysh në vitin e largët 1584. Gjithsesi që shkolla shqipe kishte funksionuar edhe gjatë vitit 1846, vit i cili është i gravuar në brendësi të absidës mbi një lastar hardhie. Shkolla ka funksionuar edhe gjatë vitit 1872, 1888, 1891, 1896. Veprimtarinë si shkollë e Parë Shqipe e mirëfilltë do ta ketë zhvilluar që nga viti 1868 me mësues Dom Mikelin. Ndërsa nga Austro-Hungaria është zyrtarizuar në vitin 1905, po ashtu, me mësuesin Dom Mikel Tarabulluzin.

Në oborrin e Kishës është përmendorja e Don Mikel Tarabuluzit, si dhe një monument kushtuar Martirëve të Karadakut, 1846-1848.

Në vitin 2011 është bërë një ndërhyrje emergjente në kulmin e objektit nga CHwB, ndërsa në vitin 2014 është bërë suvatimi nga jashtë.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet aseti, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza komparative e aseteve të njejta në nivelin lokal, nacional dhe më gjërë*
- *Autenticiteti/Integriteti*

Shkolla e parë shqipe është bartëse e vlerave specifike arkitekturore, historike, kulturore e shoqërore për fshatin Stubëll të Epërme , për komunën si dhe për tërë hapësirat shqiptare. Specifika kryesore është se llogaritet si shkollë e parë shqipe në Kosovë, sikurse edhe kishë katolike shqiptare. E ndërtuar në fshatin Stubëll të Epërme, me shekuj e vite, ka qenë pjesë e pandashme e banorëve të fshatit të rajonit e më gjerë dhe është shndërruar në simbol të arsimor, kulturor, shpirtëror e shoqëror për rajonin.

Vlerat historike: Shkolla e parë shqipe me vjetërsinë, origjinalitetin, ndërtimin, e ruajtur deri më sot paraqet një dëshmi të zhvillimeve arkitekturore, , kulturore e shoqërore të shek. XVI, sikurse edhe mbajtjen gjallë të kishës katolike të komunës së Vitisë për katësisht të fshatit Stubëll.

Vlera artistike: Nuk është ndonjë ndërtesë e madhe, megjithatë enterieri dhe eksterieri kanë elemente artistike të kohës kurë është ndërtuar. Ka përdheshën dhe katin, që karakterizohet me ndërtime dhe stilizime të veçanta. Ndërtesa është e vendosur në drejtimin perëndim – lindje dhe ka planimetri në formë të shkronjës L. Absida gjendet në murin verior, pranë së cilës ndodhet edhe altari. Nga hyrja e priftërinjve, salla ndahet me dy shtylla, të cilat mbajnë një mur në formë harku, ndërsa një ndarje tjetër ndërmjet altarit dhe pjesës tjetër të sallës është improvizuar me dy shtylla pa kapitël. Altari dhe tryeza e altarit janë veshur me gurë të përpunuar. Po kështu, edhe absida është e dekoruar me një friz, ngjyrash të shembullit të shamisë së Nënë Terezës. Në brendësi të absidës ndodhet një katror i gravuar në të cilin zë vend kryqi me Jezusin. Ndërsa edhe hajati i është i vendosur në tri shtylla

Vlera Shpirtërore: S’ka dyshim se ky objekt paraqet edhe vlera shpirtërore ngase që nga viti 1584 ka filluar punën edhe si faltore e besimit katolik. Edhe pse ka pasur ndërprerje të kohëpaskohshme, aty janë kryer ceremonitë fetare të popullatës shqiptare të kësaj ane.

Vlera shkencore: Ndërtesa e shkollës së parë shqipe në Stubëll mund të jetë objekt studimi për mënyrën e ndërtimit të objektit, materialin e saj të ndërtimit, sikurse edhe për vjetërsinë dhe rolin e saj që ka luajtur si shkollë dhe si objekt fetar që nga ndërtimi i saj e deri më tani, Pastaj edhe artistët dhe letrarët kanë hapësirë për të studiuar disa vepra arti si dhe shkrime që gjenden e mund të gjenden në të ardhmen për këtë objekt me rëndësi për trevat tona.

Vlerat shoqërore: Ky objekt ka edhe vlera shoqërore, ngase këtu janë krijuar mundësitë që të mësojnë nxënësit dhe të njihen në mes veti. Po ashtu qytetarët e fshatit e më gjerë kanë pasur rastin të takohen në rastet e ceremonive fetare, sikurse të bashkëbisedojnë për problemet e ndryshme të tyre. Edhe pse sot nuk funksionon si shkollë dhe as si vend ku kryhen ceremonitë fetare, atë e vizitojnë njerëz nga vise të ndryshme të Kosovës e më gjerë , sikurse edhe mbahen takimet letrare të Dom Mikel Tarabulluzit.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit*
- *Përshkrimi i gjendjes teknike*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet tjera ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*

Tani objekti është në gjendje të mirë. Në ndryshimin e tij, që nga fillimi e deri më tani, ka ndikuar faktori kohë dhe faktori njeri. Megjithatë, pjesës më të madhe të objektit i është ruajtur forma origjinale: Salla e lutjeve, ballkoni në katin përdhese që shërben për hyrjen në katin e parë, kornizat, fotot, mbishkrime tjera, kambanorja.

Gjatë vitit 2011 është bërë restaurimi i kulmit të Shkollës së Parë Shqipe që është realizuar nga CHWB, në bashkëpunim me QRTK (Gjilan) dhe është mbështetur nga MKRS.

Faktori natyror: Përmomentin, pas rindërtimit të kulmit, nuk mund të depërtojë shiu e lagështia, megjithatë fasada kohë pas kohe mund të dëmtohet nga shiu, bora e era.

Faktori njeri: Nuk ka frekuentim të madh në njerëzve, megjithatë pasi nuk ka ndonjë roje mund të dëmtohet objekti edhe nga brenda edhe nga jashtë. Nuk mirëmbahet si duhet, sikurse edhe mungojnë shenjat për orientim dhe materiali informues.

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi, slajda dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershme mbi statusin ligjor të asetit.*
- ***Shtojçë 1,*** *A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, formë të shtypur dhe digjitale.*
- ***Shtojca 2,*** *Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zones rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.*
- ***Shtojçë 3:*** *Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*
- ***Shtojçë4:*** *Projekt propozimet për punë hulumtuese apo ndërhyrje teknike dhe Plani i menaxhimit të asetit të propozuar për mbrojtje.*

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: QRTK - Gjilan

Hartuesit e formularit: Arton Hoxha, Ismet Tafili, Sabit Rrustemi

Personi i autorizuar:

Adresa dhe kontakti: Rr . “Adem Jashari” nr 28, Gjilan

Data:/...../.....

Nënshkrimi: